



# FLETORJA ZYRTARE

E

## REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 33

2002

Korrik

### P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.8914 datë 20.6.2002	Për ratifikimin e amendamentit të marrëveshjes së kredisë të zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin “Rehabilitimi urgjent i furnizimit me ujë” .....	1045
Ligj nr.8915 datë 27.6.2002	Për disa shtesa në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.8508, datë 7.7.1999, nr.8519, datë 30.7.1999, nr.8552, datë 18.11.1999, nr.8581, datë 17.2.2000, nr.8651, datë 28.7.2000, nr.8713, datë 15.12.2000, nr.8840, datë 11.12.2001 dhe nr.8858, datë 14.2.2002 .....	1046
Ligj nr.8916 datë 27.6.2002	Për një ndryshim në ligjin nr.8858, datë 14.2.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.8508, datë 7.7.1999, nr.8519, datë 30.7.1999, nr.8552, datë 18.11.1999, nr.8581, datë 17.2.2000, nr.8651, datë 28.6.2000, nr.8713, datë 15.12.2000 dhe nr.8840, datë 11.12.2001.....	1047
Dekret nr.3387 datë 26.6.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	1048

**LIGJ**  
**Nr. 8914, datë 20.6.2002**

**PËR RATIFIKIMIN E AMENDAMENTIT TË MARRËVESHJES SË KREDISË TË  
ZHVILLIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS  
NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN “REHABILITIMI  
URGJENT I FURNIZIMIT ME UJË”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Amendamenti i marrëveshjes së kredisë të zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin “Rehabilitimi urgjent i furnizimit me ujë””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3394, datë 3.7.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

**AMENDAMENT NR.1**

**NË MARRËVESHJEN E KREDISË SË ZHVILLIMIT PËR PROJEKTIN “REHABILITIMI  
URGJENT I FURNIZIMIT ME UJË” NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE  
SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA)**

Shkronja “b” e pikës 2/1 të listës nr.1, ndryshohet si vijon:

“pagesat në shumën ekuivalente me 2 000 000 SDR të bëra për shpenzimet në kategorinë (1) (a) për punimet e rehabilitimit, në qoftë se kontrata për operatorin privat do të miratohet deri më 30 qershor të vitit 2002”.

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË  
NDËRKOMBËTARE

PËR SHOQATËN PËR ZHVILLIM (IDA)

**LIGJ**  
**Nr. 8915, datë 27.6.2002**

**PËR DISA SHITESA NË LIGJIN NR.8435, DATË 28.12.1998 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8508, DATË 7.7.1999, NR.8519, DATË 30.7.1999, NR.8552, DATË 18.11.1999, NR.8581, DATË 17.2.2000, NR.8651, DATË 28.7.2000, NR.8713, DATË 15.12.2000, NR.8840, DATË 11.12.2001 DHE NR.8858, DATË 14.2.2002**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr.8508, datë 7.7.1999, nr.8519, datë 30.7.1999, nr.8552, datë 18.11.1999, nr.8581, datë 17.2.2000, nr.8651, datë 28.7.2000, nr.8713, datë 15.12.2000, nr.8840, datë 11.12.2001 dhe nr.8858, datë 14.2.2002 bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 shtohen pikat 25, 26 dhe 27 si më poshtë:

- “25. Mbitaksa për importet e taksueshme.
- 26. Taksa mbi konsumin e karburantit.
- 27. Taksa vjetore nga tatimpaguesit e TVSH-së për ndërtimin e Rrugës Durrës-Kukës.”.

Neni 2

Në nenin 6, në pikën “I.Taksat kombëtare”, shtohen shkronjat “u”, “v” dhe “x” si më poshtë:

“u. Mbitaksa për importet e taksueshme caktohet në masën 1 për qind për të gjitha mallrat e importuara dhe të taksueshme.

v. Taksa mbi konsumin e karburantit caktohet në masën 3 lekë për litër për gazoilin, benzinën dhe benzolin e importuar, si dhe për ata të prodhuar në vend.

x. Taksa vjetore për tatimpaguesit e TVSH-së për ndërtimin e Rrugës Durrës-Kukës caktohet në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë në vit, e cila derdhet sipas afateve të përcaktuara për taksat vjetore.”.

Neni 3

Në nenin 9, në shkronjën “A. Për taksat kombëtare:”, shtohen shkronjat “rr”, “s” dhe “sh” si më poshtë:

“rr. Për mbitaksën për importet e taksueshme ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj.

s. Për taksën mbi konsumin e karburantit ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nëpërmjet degëve të saj, për gazoilin, benzinën dhe benzolin e importuar, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për prodhuesit vendas të benzinës, gazoilit dhe benzolit.

sh. Për taksën vjetore nga tatimpaguesit e TVSH-së, për ndërtimin e Rrugës Durrës-Kukës, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet degëve të saj.”.

Neni 4

Të ardhurat nga këto taksa të përdoren vetëm për ndërtimin e Rrugës Durrës-Kukës. Fondet e papërdorura brenda vitit mbarten në vitet e ardhshme.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3396, datë 4.7.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

## **LIGJ**

**Nr. 8916, datë 27.6.2002**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8858, DATË 14.2.2002 “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8435, DATË 28.12.1998 “PËR SISTEMIN E TAKSAVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË””, NDRYSHUAR ME LIGJET NR.8508, DATË 7.7.1999, NR.8519, DATË 30.7.1999, NR.8552, DATË 18.11.1999, NR.8581, DATË 17.2.2000, NR.8651, DATË 28.6.2000, NR.8713, DATË 15.12.2000 DHE NR.8840, DATË 11.12.2001**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Neni 2 i ligjit nr.8858, datë 14.2.2002 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8435, datë 28.12.1998 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë””, ndryshuar me ligjet nr.8508, datë 7.7.1999, nr.8519, datë 30.7.1999, nr.8552, datë 18.11.1999, nr.8581, datë 17.2.2000, nr.8651, datë 28.6.2000, nr.8713, datë 15.12.2000 dhe nr.8840, datë 11.12.2001 ndryshohet:

“Ky ligj hyn në fuqi më 1 janar 2003.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.3395, datë 4.7.2002, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani.**

**DEKRET**  
**Nr. 3387, datë 26.6.2002**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Denis Vladimir Bregu
2. Enina Vladimir Abendroth (Qose)
3. Spartak Mahir Damsi
4. Fatos Bedri Shtepani
5. Albert Safet Rakipi
6. Enkeleida Meto Hoffmann (Emini)
7. Ali Ahmet Kotobelli
8. Sarah Ali Kotobelli
9. Gisela Ali Kotobelli
10. Valbona Fiqiri Kotobelli (Mirashi)
11. Fatmira Ali Mehmeti (Rada)
12. Aiksel Refik Mehmeti
13. Klarens Refik Mehmeti
14. Fatmir Ali Gashi
15. Diana Hysni Gashi (Krajka)
16. Henri Fatmir Gashi
17. Florenca Trifon Kika (Demoçi)
18. Aleksandër Themi Laçi
19. Flora Sami Kulla (Hamataj)
20. Elka Selim Kulla

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Rexhep Meidani**

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
  - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 5.7.2002  
Doli nga shtypi më 8.7.2002

Tirazhi: 4250 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2002

Çmimi: 50 lekë